

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmës gjyqtares Mirvete Alidemi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.Xh. nga ..., Rr.” ... ”, nr. ..., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.M. nga ..., me objekt kontesti, kompenzimi i pagave pas pensionimit, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike të datës: 20 Shkurt 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit S.Xh. nga ... dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditësit t’ia paguaj tri paga mujore për përcjellje në pension shumë prej 1,581.51€, për shpërblim jubilar tri paga mujore në shumë prej 1,581.51€, si dhe regresin në shumë prej 120€ në total shumë prej 3.266.04€, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1.Kronologjia e çështjes

Paditësi S.Xh. nga ..., ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 04.05.2015, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me objekt kontesti kompenzimi i pagesave pas pensionimit, dhe shpërblimin jubilar në shumë prej 1,581.51 €, tri paga mujore për përcjellje në pension po ashtu në shumë prej 1,581.51 €, si dhe regresin në shumë prej 120 €, gjithsej shumë prej 3,283.02 €, duke konfirmuar se ka punuar si mësimdhënës, pranë Shkollës së mesme Gjimnazi “ ... ” në ..., i cili është pensionuar me datë 23.02.2015, për shkak të moshës.

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje në padi, e paditura me date 24.02.2017, ka ushtruar përgjegje në padi duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, si dhe rastin ta pezulloj në afat prej 180 ditësh si dhe ta njofton Ministrinë e Drejtësisë.

Gjykata me date 09.03.2017 ka marr aktvendim për ndërprerjen e procedurës në afat prej 180 ditëve, si dhe ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Gjykata ka caktuar seancën përgaditore me date 14.12.2017, në të cilën kanë prezentuar paditësi dhe përfaqësuesi i të paditurës .

2.Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.Xh. në seancën përgaditore të datës 14.12.2017, ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së ushtruar, duke propozuar gjykatës që në bazë të provave të bashkangjitura padisë dhe në bazë të kontratës kolektive të datës 01.01.2015, e paditura t'ia paguan paditësit tri paga mujore për shpërblim jubilar në shumë prej 1,581.51 €, tri paga mujore për përcjellje në pension po ashtu në shumë prej 1,581.51 €, si dhe regresin në shumë prej 120€, gjithsej shumën prej 3,283.02€.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës në seancën përgaditore të datës 14.12.2017, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjes në paditë datës 24.02.2017, dhe se tërësi e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për shkak se kontrata kolektive që është në fuqi që nga data 01.01.2015, nuk ka efekt ligjor obligativ në raport me Komunën e Gjilanit si punëdhënës, pasi që BSPK-ja nuk ka të nënshkruar asnjë marrëveshje me Komunën e Gjilanit, dhe pasi që nuk ka të nënshkruar kurrëfar marrëveshje Komuna e Gjilanit nuk i nënshtrohet obligimeve që dalin nga kontrata kolektive. Pasi që kjo kontratë kryesisht i referohet anëtarëve të sindikatës, dhe tri pagat për pension dhe pagat jubilarë ju takojnë vetëm anëtarëve të sindikatës.

3.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Kërkesa e paditësit adresuar Drejtorisë së Arsimit në Gjilan, mbi mospagesën e pagave për pension e dates: 10.03.2015, Përgjegjja e DKA-së në kërkesën e S.Xh. e dates 17.03.2015, Letërnjoftimi në emër të S.Xh., Aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit në emër të S.Xh. e dt:02.02.2015, Vërtetimi I lëshuar nga Gjimnazi “ ... ”, në Gjilan e dt: 10.03.2015, Vendimi në emër të S.Xh. për njohjen e të drejtës në pension e dt: 02.03.2015, dhe Libreza e punës me numër ...

Paditësi S.Xh. në seancën kryesore të datës 07.02.2018, ka deklaruar gjykata ti aprovoj kërkesën e tij dhe të obligohet Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Arsimit që në emër të regresit ti paguaj shumën prej 120 € për shpërblim jubilar shumën në të holla prej 1,581.51 € dhe për përcjellje në pension tri paga në të holla në shumë prej 1,581.51 €, të gjitha në vlerë të përgjithshme prej 3,283.02 €, me kamat ligjore prej 3.2%, ashtu siq paguajn Bankat e Kosovës.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës në fjalën përfundimtare¹, ka deklaruar se në tërësi e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për shkak se kontrata kolektive që është në fuqi që nga data 01.01.2015, nuk ka efekt ligjor obligativ në raport me Komunën e Gjilanit si punëdhënës, pasi që BSPK-ja nuk ka të nënshkruar asnjë marrëveshje me Komunën e Gjilanit, dhe pasi që nuk ka të nënshkruar kurrëfar marrëveshje Komuna e Gjilanit nuk i nënshtrohet obligimeve që dalin nga kontrata kolektive. Pasi që kjo kontratë kryesisht i referohet anëtarëve të sindikatës, dhe tri pagat për pension dhe pagat jubilarë ju takojnë vetëm anëtarëve të sindikatës.

4.Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe provave të paraqitura, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike edhe atë : nga aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.061-10923/2015, të datës 02.02.2015,gjykata vërtetoi faktin se paditësi

¹ Përfaqësuesi I të paditurës fjalën përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim.

për shkak të moshës së pensionit 65 vjeçar i është ndërprerë marrëdhënia e punës, nga vërtetimi I I dt: 10.03.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka përvijë pune profesionale gjithsej 41 vite e 5 muaj e 23 ditë të lëshuar nga SHM Gjinnazi “ ... ”, në ..., nga leximi i librezës së punës me numer ..., gjykata vërtetoi se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune që nga data 11.12.1973, ndërsa nga kërkesa e drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjiilan me datë 10.03.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kërkuar kompensimin e tri pagave mujore për përcjellje në pension, si dhe tri pagave mujore për shpërblim jubilar në mbështetje të kontratës kolektive dhe akteve tjera nënligjore gjithsej prej 3,283.51 € bruto, ndërsa nga përgjegjja në kërkesës me numër ..., e datës 17.03.2015, gjykata konstatoi se Drejtoria Komunale e Arsimit i është përgjegjës paditësit sa i përket zbatimit të kontratës kolektive duke e cekur se ekzekutimin e pagave e bënë Ministria e Administratës Publike gjegjësisht divizioni i pagave në kuadrin të kësaj Ministrie dhe se ende nuk është u zbatuar kontrata kolektive, si dhe nga leximi i listës së pagave për muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të viti 2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka realizuar të ardhura mujore në shumë prej 527.17 € bruto, ndërsa 472.79 € neto.

Andaj gjykata bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se paditësi ka të drejtën e kompensimit të pagave edhe atë duke u mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar përkatësisht në nenin 36 paragrafi 9 dhe 10, si dhe nenin 51 të kësaj kontrate shprehimisht thuhet se implikimet financiare fillojnë të zbatohen që nga data 01.01.2015, e që paditësi sipas aktvendimit me numër 061-10923/2015, të datës 02.02.2015, i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit (pensionimit) .

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e cekura më lartë, e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, si dhe nenin 450 u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. .

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Më datë: 21.02.2018

Gjyqtarja

Mirvete Alidemi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit.